



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT ME REKOMANDIME

A.nr. 262/2014
Dragan Mihajlović

lidhur me zvarritjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në lëndën AC.nr.3930/2016

Për: **Z. Hasan Shala, Kryetar**
Gjykata e Apelit

Prishtinë, më 1 dhjetor 2017

Qëllimi i raportit

1. Raporti bazohet në ankesën e paraqitur të z. Dragan Mihajlović (në tekstin e mëtejshëm: “ankuesi”) dhe bazohet në faktet dhe provat që i ka paraqitur ankuesi, si dhe në shkresat, të cilat i disponon Institucioni i Avokatit të Popullit (në tekstin e mëtejshëm: “IAP”).
2. Qëllimi i këtij raporti është që t’i tërhiqet vëmendja Gjykatës së Apelit në Prishtinë në lidhje me domosdoshmërinë e ndërmarrjes së veprimeve të duhura për shqyrtimin dhe vendosjen në rastin e ankesës së ankuesit dhe ankesës së të paditurit pa vonesa të mëtejshme, duke pasur parasysh se bëhet fjalë për lëndën që i është dorëzuar gjykatës së shkallës së parë në Prizren që në vitin 2004 dhe deri më sot lënda e njëjtë nuk e ka epilogun e vet final.

BAZA LIGJORE

3. Sipas nenit 135, para. 3 të Kushtetutës: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.”*
4. Po ashtu, Ligji Nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, neni 16 paragrafi 8, përcakton se: *“Avokati i Popullit mund të jep rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësor. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe në procedura tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurave”.*

Përmbledhje e fakteve

Faktet, dëshmitë dhe informatat me të cilat posedon Institucioni i Avokatit të Popullit (IAP), mund të përmbliidhen si në vijim:

5. Më 30 maj 2014, *ankuesi* ka paraqitur ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit që ka të bëjë me kohëzgjatjen e procedurës në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, për kompensimin e pasurisë së konfiskuar në mënyrë të paligjshme nga ana e Komunës së Prizrenit, Drejtorisë për arsim, shkencë e kulturë (në tekstin e mëtejshëm "e paditura"). Ankuesi e ka iniciuar një padi, në ish Gjykatën Komonale, kurse tani Gjykatën Themelore në Prizren, më 24 dhjetor 2004 (C.br.2231/04). Gjykata Themelore ka nxjerrë aktgjykimin e shkallës së parë, më 26 mars 2013, në favor të ankuesit. Më 11 nëntor 2015, Gjykata e Apelit e anulon vendimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Prizren dhe lënda i kthehet për rigjykim gjykatës së njëjtë. Më 29 prill 2016, Gjykata Themelore në procedurën e përsëritur nxjerr aktgjykim në favor të ankuesit. Më 25 tetor 2016, sipas ankesës së të paditurit lënda përsëri i dërgohet Gjykatës së Apelit për shqyrtim sipas ankesës në fjalë.
6. Ankuesi pohoi se Gjykata e Apelit në mënyrë të panevojshme po vonohet në shqyrtimin e rastit të tij.
7. Më 5 qershor 2014, ankesa është regjistruar në IAP (nr. Ankesa 262/2014).
8. Më 16 qershor 2014, Avokati i Popullit i dërgoi një letër kryetarit të Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes të cilës i kërkoi t’ia dërgojnë informatat lidhur me veprimet e ndërmarra

dhe/ose aktivitetet e planifikuara me qëllim që rasti të zgjidhet brenda një afati të arsyeshëm kohor.

9. Më 19 qershor 2015, Avokati i Popullit e mori përgjigjen nga zyrtari përgjegjës për informim i Gjykatës së Apelit, përmes së cilës ai njofton Avokatin e Popullit që lënda e këtij ankuesi në Gjykatën e Apelit tani është e evidentuar me numrin AC.br.3132/2013, se lënda në këtë gjykatë është regjistruar më 22 tetor 2013, se i ndarë në punë një gjykatësi dhe është në pritje për shqyrtim.
10. Më 24 shtator 2014, Avokati i Popullit i dërgoi letrën e dytë kryetarit të Gjykatës së Apelit, përmes të cilës kërkoi të informohet për fazën e trajtimit në të cilën gjendet lënda e ankuesit në Gjykatën e Apelit.
11. Më 10 tetor 2014, Avokati i Popullit e mori një përgjigje nga zyrtari përgjegjës për informim i Gjykatës së Apelit, në të cilën përsëri theksohet që rasti i ankuesit i është ndarë në punë një gjyqtari dhe lënda është në pritje për shqyrtim. Gjithashtu, në përgjigje është cekur se tani Gjykata e Apelit është duke punuar në lëndët nga viti 2012 dhe se Gjykata pas këtyre lëndëve do të vazhdojë të punojë në rastet e pranuar gjatë viteve 2013 dhe 2014.
12. Më 22 prill 2015, Avokati i Popullit i dërgoi një letër të tretë kryetarit të Gjykatës së Apelit, në të cilën konstatoi se të dy përgjigjet e Gjykatës së Apelit kishin të njëjtën përmbajtje, ndonëse periudha kohore në mes të dy letrave ishte katër muaj dhe se nuk është ndërmarrë asnjë veprim konkret për ta zgjidhur lëndën brenda një periudhe të arsyeshme kohore, veçanërisht nëse merret parasysh fakti se mosmarrëveshja e ankuesit me Komunën e Prizrenit zgjat më shumë se dhjetë vite. Me atë rast Avokati i Popullit kishte kërkuar që ta informojnë në cilën fazë të trajtimit gjendet lënda e ankuesit në Gjykatën e Apelit.
13. Më 6 maj 2015, Avokati i Popullit mori përgjigje nga zyrtari i zyrës për informim i Gjykatës së Apelit, në të cilën ceket se lënda e ankuesit nuk bën pjesë në lëndët emergjente. Në shkresë gjithashtu theksohet se gjyqtari i lëndës nuk ka mund të veprojë në këtë lëndë për shkak se është i stërngarkuar me një numër të madh të lëndëve dhe se Gjykata e Apelit ka filluar të punojë në rastet e viti 2013. Në letër më tej thuhet se meqë Gjykata e Apelit ka vetëm 10 gjykatës dhe 2214 lëndë të pazgjidhura, të njëjtat nuk mund t'i zgjidhë brenda një afati kohor të arsyeshëm.
14. Më 11 nëntor 2015, ankuesi e informoi Institucionin e Avokatit të Popullit se Gjykata e Apelit ka nxjerrë aktvendim në lëndën e tij, me të cilin e anuloi aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren dhe çështjen e ktheu për rishqyrtim në të njëjtën gjykatë.
15. Më 11 janar 2016, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës Themelore në Prizren, me të cilën kërkoi që lëndës në fjalë t'i jepet përparësi në trajtim.
16. Më 25 janar 2016, Avokati i Popullit mori përgjigje nga kryetari Gjykatës Themelore në Prizren, i cili e informoi që lëndës së ankuesit i është dhënë përparësi dhe do të zgjidhet në të ardhmen e afërt.

17. Më 5 shtator 2016, kryetari Gjykatës Themelore në Prizren, e informoi Avokatin e Popullit se lënda e ankuesit është zgjidhur më 29 prill 2016 dhe se aktgjykimi u është dorëzuar palëve në procedurë më 31 gusht 2016. Gjithashtu, përfaqësuesi ligjor i ankuesit e informoi Institucionin e Avokatit të Popullit që pala e paditur në procedurë përsëri ka paraqitur ankesë kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prizren.
18. Më 25 tetor 2016, Avokati i Popullit i dërgoi letër u.d. të kryetares së Gjykatës së Apelit dhe kërkoi urgjencë në shqyrtimin e lëndës së ankuesit dhe shprehu shqetësimin e tij për shkak se kontesti pronësor në fjalë po zgjat tashmë 13 vjet duke përfshirë shkallën e parë dhe të dytë.
19. Më 7 nëntor 2016, Avokati i Popullit e pranoi një shkresë nga u.d. të kryetares së Gjykatës së Apelit, në të cilën ajo e informonte që lënda e ankuesit sipas ankesës së palës së paditur është zgjidhur dhe aktgjykimi në Gjykatën e Apelit është nxjerrë më 4 nëntor 2016.
20. Më 14 prill 2017, Avokati i Popullit i dërgoi letër kryetarit të Gjykatës së Apelit, në të cilën kërkoi që vendimi i Gjykatës së Apelit sipas ankesës së ankuesit t'u dërgohet palëve në procedurë, duke u thirrur në letrën paraprake të u.d të kryetares së Gjykatës së Apelit, në të cilën ajo e kishte informuar që lënda është zgjidhur në nëntor të vitit 2016.
21. Më 20 prill 2017, Avokati i Popullit mori një letër nga kryetari i Gjykatës së Apelit, në të cilën e informon që Gjykata e Apelit nuk ka marrë vendim sipas lëndës së ankuesit dhe se lënda në fjalë edhe më tej pret për t'u shqyrtuar.
22. Deri në datën e publikimit të këtij raporti, Gjykata e Apelit nuk ka marrë vendim për rastin e ankuesit, i cili tani është i evidentuar me numrin AC.nr.3930/2016.

Instrumentet ligjore të zbatueshme në Republikën e Kosovës

23. Neni 1 i Ligjit për Procedurën kontestimore nr. 03/L-006 dhe Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Procedurën kontestimore 04/L-118 (në tekstin e mëtejshëm “Ligji për Procedurën Kontestimore”), në pjesën përkatëse thekson:

“Me Ligjin për procedurën kontestimore caktohen rregullat procedurale në bazë të të cilave gjykata i shqyrton dhe i zgjidhë kontestet nga marrëdhëniet juridiko-civile të personave fizikë dhe juridikë, po që se me ligj të posaçëm nuk është përcaktuar ndryshe.”
24. Neni 10, pika 1 e Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

“Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje dhe me sa më pak shpenzime, si dhe të bëjë të pamundur çdo shpërdorim të së drejtave procedurale që u takojnë palëve sipas këtij ligji.”
25. Neni 176 i Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

“176.1 Kundër aktgjykimit të dhënë nga gjykata e shkallës së parë palët mund të bëjnë ankim brenda afatit prej pesëmbëdhjetë ditësh (15) nga dita e dorëzimit të kopjes së aktgjykimit, po që se me këtë ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër. [...]

176.2 Ankimi i bërë brenda afatit të përcaktuar me ligj pengon që aktgjykimi të bëhet i formës së prerë në pjesën e goditur me ankim.

176.3 Mbi ankimin kundër aktgjykimit vendosë gjykata e shkallës së dytë ...”

26. Neni 185 i Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

- a. *“Ankesa i paraqitet gjykatës e cila e ka dhënë aktgjykimin e shkallës së parë, në një numër të njaftueshëm ekzemplarësh për gjykatën dhe palën kundërshtare...”*

27. Neni 187 i Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

„187.1 Një ekzemplar të ankesës së paraqitur me kohë, të lejueshme dhe të plotë, gjykata e shkallës së parë ia dërgon palës kundërshtare, e cila mundet, brenda afatit prej shtatë ditësh, të paraqesë po në këtë gjykatë përgjigje në ankese. [...]“.

28. Paragrafi 1 i nenit 190 të Ligjit për Procedurën kontestimore thotë:

“Gjykata e shkallës së dytë vendosë për ankesën në seancë të trupit gjykues ose në bazë të shqyrtimit të çështjes në seanca gjyqësore. [...]”

29. Paragrafi 1 i nenit 6 të Konventës Europiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore (4 nëntor 1950) (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), thotë:

“Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm ligjor nga [...]”

30. Neni 13 i KEDNJ-së thotë:

“Çdo person, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e njohura në këtë Konventë, ka të drejtë të paraqesë një ankim efektiv përpara një instance kombëtare, edhe kur kjo shkelje ka qenë kryer nga persona që veprojnë brenda ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare...”

Analiza ligjore

32. Ankuesi ka parashtruar ankesë lidhur me kohëzgjatjen e procedurës civile në Gjykatën Themelore në Prizren dhe Gjykatën e Apelit. Ai ankohet se e ka pritur aktgjykimin e shkallës së parë të Gjykatës Themelore gati 10 vjet, por pas marrjes së aktgjykimit të shkallës së parë dhe parashtrimit të ankesës kundër të njëjtit nga ana e paditurit, Gjykata e Apelit e ktheu lëndën në rishqyrtim, ndërsa aktgjykimi përsëri u nxor në favor të ankuesit në prill të vitit 2016, kundër të cilit përsëri u parashtrua ankesë nga ana e Komunës së Prizrenit, kurse lënda sipas ankesës i është përcjellë për shqyrtim Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e cila që nga dita e parashtrimit të ankesës kundër aktgjykimit të shkallës së parë të Gjykatës Themelore në Prizren deri në ditën e publikimit zë këtij raportit nuk ka vendosur në shkallën e dytë. Ankuesi ankohet që rasti qëndron i pazgjidhur një kohë relativisht të gjatë, përkatësisht procedura në këtë padi ka zgjatur për më shumë se 13 vjet dhe pikërisht kjo përbën shkelje të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ-së, i cili thotë:

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të tij civile [...] çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm [...]”

33. Parimi i njëjtë ekziston në nenin 10 të Ligjit për procedurën kontestimore, i cili thotë:
 “Gjykata ka për detyrë të përpiqet që procedura të zhvillohet pa zvarritje [...]”
34. Në fillim, Avokati i Popullit vëren se kontestet civile për kompensim të dëmit për eksproprihimin e padrejtë të pasurisë së paluajtshme nga autoritetet publike, në rastin konkret nga Komuna e Prizrenit, konsiderohen si të drejta civile, në kuptim të nenit 6 të Konventës, i cili për këtë arsye është i zbatueshëm në procedurat e këtij rasti.
35. Avokati i Popullit rikujton se praktika gjyqësore e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejshëm: GJEDNJ) ka konstatuar që në rastet të cilat përfshijnë caktimin e të drejtës civile, kohëzgjatja e procedurave llogaritet nga koha e fillimit të procedurës gjyqësore (shih shembullin, *Sienkiewicz kundër Polonisë*, aktgjykimi i 30 shtatorit 2003) deri në kohën kur për çështjen vendoset përfundimisht dhe/ose aktgjykimi ekzekutohet (shih *Vocaturò kundër Italisë* (II), aktgjykimi i datës 24 maj 1991).
36. Avokati i Popullit vëren se procedura është iniciuar me padi kundër Komunës së Prizrenit më 24 dhjetor 2004 pranë atëherë në Gjykatën Komunale, tani Themelore në Prizren dhe zgjat edhe sot e kësaj dite. Për këtë arsye, procedurat zgjasin gati 13 vjet në dy instanca.
37. Avokati i Popullit përkujton se arsyeshmëria e kohëzgjatjes së procedurës duhet të vlerësohet në dritën e rrethanave të caktuara të çështjes, duke marrë parasysh kriteret e caktuara nga praktika gjyqësore, veçanërisht kur bëhet fjalë për kompleksitetin e çështjes, sjelljen e palëve në procedurë dhe autoriteteve që punojnë në rast, si dhe asaj se çfarë është në interes të ankuesit (shih rastin *Gollner kundër Austrisë*, aktgjykimi i datës 17 janar 2002).
38. Avokati i Popullit vëren se rasti i ankuesit nuk ishte i ndërlikuar dhe se sjellja e ankuesit nuk ka kontribuar në ndonjë vonesë.
39. Sa u përket veprimeve të organeve gjyqësore, Avokati i Popullit konstaton se sipas përgjigjes së Gjykatës së Apelit, vonesat për shqyrtimin e rastit të ankuesit janë shkaktuar për shkak se herën e parë lënda në fjalë nuk është trajtuar si lëndë me prioritet, si dhe për shkak të numrit të vogël të gjyqtarëve, të cilët merren me çështjet civile, konkretisht me çështjen e kompensimit të dëmeve, gjë që shkakton ngarkesën e madhe e gjyqtarëve me lëndë. Përveç kësaj, në përgjigjen e fundit, të cilën e ka marrë Avokati i Popullit nga Gjykata e Apelit, më 14 prill 2017, thuhet se rasti ende është në pritje për shqyrtim sipas radhës, edhe pse Avokati i Popullit disa herë në letrat e tij ka theksuar që çështja nuk duhet të trajtohet si rast i ri, për shkak se procedurat gjyqësore në këtë rast janë duke zgjatur që nga viti 2004, pa ndonjë shenjë për përfundimin e saj.
40. Avokati i Popullit rikujton se në lëndën e lartpërmendur *Vocaturò kundër Italisë*, qeveria italiane deklaroi se arsyeja për vonesë në procedurë ka ardhur si rezultat i numrit të madh të lëndëve të vjetra në gjykata. Në këtë rast, Gjykata ka konsideruar që neni 6, paragrafi 1 ua imponon shteteve detyrimin që t’i organizojnë sistemet e tyre ligjore, në mënyrë të tillë që gjykatat t’i plotësojnë kërkesat e KEDNJ. Megjithatë, ngecja e përkohshme në punë nuk e përfshin përgjegjësinë e shtetit, me kusht që me kohë të ndërmerren masat e duhura dhe të merren me situata të kësaj natyre (shih *Milasi kundër Italisë*, aktgjykimi i 25

qershorit 1987. Shih, gjithashtu, *Foti dhe të tjerët kundër Italisë*, aktgjykimi i 10 dhjetor 1982).

41. Madje edhe nëse e marrim parasysh faktin se gjyqësori po ballafaqohet me numrin e madh të lëndëve të pashqyrtuara për shkak të mungesës së gjyqtarëve, gjykatat kompetente edhe më tej e kanë obligim që ta sigurojnë drejtësinë me kohë. Në këtë drejtim, Avokati i Popullit gjithashtu rikujton se neni 10 i Ligjit të Procedurës Kontestimore thotë që gjykatat do të “zbatojnë procedurat pa vonesa të panevojshme”.
42. Në periudhën prej 25 tetorit 2016 deri sot Gjykata e Apelit nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me lëndën e ankuesit. Kështu që lëndës nuk i është dhënë vëmendje e duhur, siç kërkon neni 6, paragrafi 1 i KEDNJ dhe neni 10 i Ligjit për Procedurën Kontestimore. Rasti para Gjykatës nuk ka qenë i ndërlikuar dhe ka mundur të zgjidhet lehtë pa pasur nevojë të sigurohen prova shtesë, të mbahen seanca të shumta ose të ndërmerren veprime tjera që do të mund të ndikonin në zvarritje të arsyeshme në shqyrtimin e lëndës. Për më tepër, Avokati i Popullit vëren se rasti është i rëndësisë së posaçme për ankuesin, i cili jeton si person i zhvendosur në Republikën e Serbisë dhe për të cilin ndihma sociale është burimi i vetëm për jetesë, e cila mezi i mjafton t’i mbulojë shpenzimet elementare për jetë.
43. Në dritën e asaj që u tha më lartë, Avokati i Popullit e konsideron që dështimi i autoriteteve që të punësojë numrin e duhur të gjyqtarëve për t’u marrë me numrin e madh të lëndëve nuk mund të konsiderohet si justifikim i vlefshëm për një vonesë të tillë në Gjykatën e Apelit. Avokati i Popullit konsideron që kjo përgjegjësi i takon Këshillit Gjyqësor të Kosovës, që të garantojë me kohë shpërndarjen e kontesteve civile përmes emërimit të një numri adekuat të gjyqtarëve, apo përmes mjeteve dhe procedurave të tjera të përshtatshme.

Konstatimi i Avokatit të Popullit

44. Avokati i Popullit konstaton se për këtë shkak ka ardhur deri te shkelja e të drejtës për një gjykim të drejtë brenda një afati të arsyeshëm të garantuar me paragrafin 1 të nenit 6 të KEDNJ.

E drejta për zgjidhje efektive: Neni 13 i KEDNJ

45. Ankuesi parashtrroi ankesë në mungesën e një mjeti efektiv në kuptim të shkeljes të të drejtës së tij për një proces të rregullt brenda një afati të arsyeshëm, të garantuar me nenin 6 të KEDNJ që përbën shkelje të të drejtës së tij për një zgjidhje efektive sipas nenit 13 të KEDNJ, i cili thotë:

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare”.

46. Për sa i përket zbatueshmërisë së nenit 13, Avokati i Popullit rikujton se GJEDNJ disa herë ka theksuar që vonesat e tepërta në administrimin e drejtësisë në aspektin kur pala nuk ka mjet efektiv ligjor në dispozicion, përbën kërcënim të sundimit të ligjit brenda

sistemit juridik të brendshëm (shih, për shembull, *Bottazzi kunder Italsë*, aktgjykimi i 28 korrikut 1999 dhe *Di Mauro kundër Italisë* aktgjykimi i 28 korrikut 1999). Avokati i Popullit rikujton gjithashtu se ndonëse GJEDNJ konsideron se kërkesat për një mjet efektiv ligjor duhet të interpretohen në kuptimin që mjeti juridik mund të jetë efektiv në aspektin e fushëveprimit të kufizuar të kërimit të ndihmës thelbësore në kontekstin e caktuar (*Klass dhe të tjerët kundër Gjermanisë* aktgjykimi i 6 shtatorit të vitit 1978), duke konsideruar se :

“Lidhur me dështimin e cekur që të sigurohet gjykimi brenda një afati të arsyeshëm kohor [...] asnjë kualifikim thelbësor brenda fushëveprimit të nenit 13 nuk mund të dallohet. Në të kundërtën, vendi i nenit 13 në skemën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut, të parapara në Konventë do të diskutoheshin në favor të kufizimeve të theksuara të nenit 13 dhe do të mbaheshin minimalisht. (Kudla kundër Polonisë, aktgjykimi i datës 26 tetor 2000).

47. Neni 13 pasqyrohet drejtpërdrejt në detyrimin e shteteve që përmes sistemeve të veta gjyqësore t'i mbrojnë të drejtat e njeriut dhe në këtë mënyrë t'i krijojnë garanci shtesë personit, gjë që do t'i siguronte atij ose asaj që këto të drejta t'i gëzojë në mënyrë efikase. Shikuar nga kjo perspektivë, e drejta e një personi për gjykim brenda një kohe të arsyeshme kohore do të jetë më pak efikase, nëse nuk ekziston asnjë mundësi që të paraqitet një ankesë ndaj autoriteteve shtetërore. Dispozitat e nenit 13 i përforcojnë ato të nenit 6 (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*). Për këtë arsye neni 13 garanton një mjet ankimi efikas ndaj autoriteteve kombëtare për shkeljen e pretenduar të dispozitave të nenit 6 për mbyllje të çështjes brenda një kohe të arsyeshme. Meqë ky rast ka të bëjë me një ankesë në lidhje me kohëzgjatjen e procedurës, neni 13 i Konventës është i zbatueshëm.
48. Në kuptim të dispozitave të nenit 13 të KEDNJ, Avokati i Popullit rikujton se efekti i këtij neni është që të kërkojë sigurimin e një mjeti ligjor vendor që të merret me çështjen e "ankesës kontestuese" sipas KEDNJ dhe të japë kompensimin e duhur financiar (*Kaya kundër Turqisë* gjykimi i 19 shkurtit 1998.). Çdo mjeti i tillë juridik duhet të jetë efektiv në praktikë dhe në ligj (*Ilhan kundër Turqisë* aktgjykimi i 27 qershorit 2000.). Në lidhje me ankesën në kohëzgjatjen e procedurës, Avokati i Popullit rikujton që "mjeti ligjor efektiv" në kuptim të nenit 13 të KEDNJ duhet të jetë në gjendje ta parandalojë shkeljen e pretenduar, ose vazhdimin e të njëjtës, ose sigurimin e kompensimit adekuat për çfarëdo shkelje që ka ndodhur tashmë (shih aktgjykimin e lartpërmendur *Kudla*).
49. Avokati i Popullit vëren se nuk ekziston asnjë qasje ligjore, përmes së cilës ankuesi në rastin konkret ka mund të ankohej për zvarritjen e procedurës me mundësi të realizimit të ndihmës parandaluese apo kompensuese.
50. Për këtë arsye, Avokati i Popullit konstaton se ka pasur shkelje të të drejtave të ankuesit për një mjet ligjor efektiv të garantuar me nenin 13 të KEDNJ.

Prandaj, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, “[...] *Ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve*

të tjera shtetërore”, dhe nenin 16, paragrafi 8 të Ligjit për Avokatin e Popullit, sipas të cilit “Avokati i Popullit mund të jap rekomandime të përgjithshme për funksionimin e sistemit gjyqësorë. Avokati i Popullit nuk do të ndërhyjë në rastet dhe procedurat tjera ligjore që janë duke u zhvilluar para gjykatave, përveç rastit kur ka zvarritje të procedurës”, bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin gjyqësor të Kosovës:

REKOMANDIM

Gjykatës së Apelit

- ***Që pa vonesa të mëtutjeshme t’i ndërmerr të gjitha veprimet përkatëse për shqyrtimin dhe vendosjen për lëndën. AC.nr.3930/2016***

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj”) dhe nenin 28 të Ligjit për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, . . . duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigjja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë”), mirësisht Ju lutem të na informoni për veprimet që keni ndërmarrë, ose planifikoni t’i ndërmerrni në lidhje me këtë çështje.


Me nderime,
Hilmi Jashari
Avokat i Popullit